



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 39 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 3.1 dhe 3.3 të Rregullës Zgjedhore 12/2013 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 15.05.2017, merr këtë:

V E N D I M

Për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton limitin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 11 Qershor 2017, në shumën prej është 942,573.5 € (nëntëqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent).
- II. Neni 3.1 i Rregullës Zgjedhore nr. 12/2013, Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, parasheh që kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të jetë 0.5 euro për votues të regjistruar. Numri i votuesve sipas listës preliminare të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës është **1.885,147** (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) votues të regjistruar.
- III. Shpenzimet maksimale për fushatë nga pika 1 e këtij vendimi zbatohen për çdo mall dhe shërbime të shpenzuara për qëllimet e fushatës, pa marrë parasysh kohën e blerjes së shërbimeve.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

